Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Dokumentat standarde të tenderit

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 7/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në

Dokumentat standarde të tenderit

datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;

e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

F) Lista e Informacionit Konfidencial.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Dokumentat standarde të tenderit

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, në marrëveshjen e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht, duhet të përcaktohen saktë përqindja e pjesëmarrjes së punës /shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojme te paraqiten:

2.2.1.Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2.Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018, 2019, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit (2017, 2018, 2019) në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata e shërbimit, vërtetim I realizimit me sukses i lëshuar për të njëjtën kontratë dhe faturën tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Dokumentat standarde të tenderit

2.3.2.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

1. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me deklaratë të vecantë 2 Drejtues Teknik të shërbimit të pastrimit të Bashkise Librazhd, me eksperiencë pune mbi 5 vjet dhe i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar 2019 – Maj 2020.

2.1.1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert ne fushen e Mjedisit) për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, çertifikatë e lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

2.1 .2.kontratë pune të vlefshme dhe diplomë për 1(një) inxhinier mekanik me eksperiencë pune mbi 5 vjet.

2. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për 1(një) inxhinier i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar 2019 – Maj 2020.

3. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse për 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin,i cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar 2019 – Maj 2020.

4. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu:

a.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave).

b. Kontratë e vlefshme shërbimi me një subjekt tjetër i cili duhet të ketë objekt të veprimtarisë së tij riparimin e mjeteve motorrike. Të paraqitet, për të provuar këtë kusht, kontratë e vlefshme shërbimi dhe leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura(“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.3.Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme

2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente dhe e vlefshme

Dokumentat standarde të tenderit

3. OHSAS 18001 (Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme
4. ISO 39001 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore)/ekuivalente dhe e vlefshme
5. SA 8000 (Standard për certifikimin social në fushën e Përgjegjësisë Sociale)/ekuivalente dhe e vlefshme .

2.3.4.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 25 (njëzet e pesë) punonjës për periudhën janar 2019 – Maj 2020, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
2. Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore 5 (pesë) shofer dhe të paktën njeri nga ata të jete edhe manovrator, të jete përdorues i makinave teknologjike fshirje/larje me leje drejtimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi aftësie profesionale të lëshuar nga institucionet përkatëse.
3. Listpagesat, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore, për periudhën janar 2019 – maj 2020.

Stafi I kerkuar me siper te figuroje ne listpagesat e shoqerise gjate periudhes Janar 2019 – Maj 2020.

2.3.5.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

1. Leje mjedisore me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me objekt stacion transferimi me vendodhje brenda Qarkut Elbasan.
2. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
3. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për transportim të mjetëve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)

4. Gjithashtu, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me:

- a. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1 A për pastrim larje sprucim kontinieresh ose
 - b. Kontratë shërbimi për pastrim larje sprucim kontiniereshme një subjekt tjetër i cili duhet të jetë i pajisur me Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1 A për pastrim larje sprucim kontinieresh.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura (“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.3.6.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak

Dokumentat standarde të tenderit

- se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit 2004 e më pas, jo më pak se 1 (një) copë;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit 2012 e më pas, jo më pak se 1 (një) copë;
3. Makinë teknologjike transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit 2012 e më pas, jo më pak se 1 (një) copë;
4. Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 1000 litra ujë, i vitit të prodhimit 2012 e më pas, jo më pak se 1 (një) copë;
5. Mjet pastrimi (gazelone) me kapacitet mbajtës 0,5-1.5 ton, me ngarkim fundor ose anësor jo më pak se 1 (një) copë i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012.
6. Mjet teknologjik për fshirjen e rrugëve (autofshesë) vit prodhimi jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë.
7. Fadromë me goma, jo më pak se 1 (një) copë.
8. REZERVE - Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit 2012 e më pas, jo më pak se 1 (një) copë;
9. Kazan (karroca dore) , 25 cope te vertetuar me fature tatimore shitje ne pronesi ose me kontrate qeraje .

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në formën e një deklarate mjetet e mësipërme në të cilën të përcaktohet targat, lloji, numri i shasisë.

Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorit ekonomik si: Numër cel, adresë e-mail, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet data dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Librazhd. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruara në tender, do të përbëj shkak për skualifikim. Gjithashtu ndryshimet që mund të përkojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëj shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti 3.3.6, plotësohet nga të gjithë anëtarët e

Dokumentat standarde të tenderit

bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.7.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera jo me larg se 7 km nga qendra e qytetit të Librazhdit për evitimin e kostove shtese.Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ambjenti me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² duhet të ketë të miratuar Projektin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të jetë i certifikuar me Certifikatën e Sigurisë të lëshuar nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpetimim.

2.3.8.Operatorët ekonomikë, për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të kenë apo mund t'i vihen në dispozicion 339 kazane nga të cilat:

-179 kazane ka aktualisht Bashkia në inventare,

-160 kazane duhet të sigurojë operatori ekonomik sipas specifikimeve teknike të DST, me qëllim mbulimin e 309 pikave të vendosura për kazanet në të gjitha zonat që mbulohen me shërbim dhe 30 kazanë rezerve/zevendësim për rastet kur merren për larje/disefektim/riparim.Për të provuar këtë duhet të paraqitet:

- a. dokumentacion i vlefshëm që vërteton disponimin e 160 cope kazane nga vetë operatori.
- b. kontrata e qerasë e vlefshme dhe e shoqëruar me dokumentacion justifikues të pronësisë së 160 kontinerëve të qiradhënësit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura (“a” ose “b”) e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.9. Operatorët ekonomikë, për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të garantojnë se kanë kapacitetet e nevojshme për mirëmbajtjen e kazanëve.

Për të provuar këtë duhet që operatorët ekonomikë:

1.të kenë në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe mirëmbajtjen e kazanëve.

2.të paraqitet kontrata noteriale paraprake e furnizimi/shërbimi për mirëmbajtjen e kazanëve me të tretët të cilët duhet të kenë në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe mirëmbajtjen e kazanëve të shoqëruar edhe me certifikatën e cilësisë ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme .

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.10.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencë profesionale të shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP-12 (punime të inxhinierisë së mjedisit).

Shënim:

1. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t'i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës,

Dokumentat standarde të tenderit

datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

2. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kritereve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklarata me shkrim.

- ***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose dorëzimit të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

Ne respektim të nenit 23 të LPP-se ne të gjitha rastet kur përmendet "marke" përfshihet termi "ekuivalent".

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

BASHKENGJITUR DST

Specifikimi i Materialeve:

BASHKENGJITUR DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

BASHKENGJITUR DST

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

BASHKENGJITUR DST

Afatet e ekzekutimit:

52 muaj nga lidhja e kontrates.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

Dokumentat standarde të tenderit

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të

Dokumentat standarde të tenderit

shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat standarde të tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

- 2.8 “Termt e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikak Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
